



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nationalni Autoritet za Kvalifikacije  
National Qualification Authority

Numër: 011.521  
Datë: 15.12.2020

Bazuar në nenin 8 të Ligjit mbi Kualifikimet Kombëtare, Udhëzimin Administrativ nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, si dhe Udhëzimin Administrativ nr.09/2019 për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP), Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e rregullt të mbajtur me 01.12.2020 mori:

## V E N D I M

Miratohet Rregullorja Nr.01.2020 për përcaktimin e procedurave për Aplikimin e Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimit (KKK), dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP).

### Dispozita të përgjithshme

#### Neni 1

#### Qëllimi

1. Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave për aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional (tash e tutje IAAP), për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (tash e tutje NjMP).
2. Gjithashtu, përmes kësaj Rregulloreje do të definohen procedurat në fazën para dhe pas aplikimit të IAAP në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve (tash e tutje AKK).
3. Kjo Rregullore do të definojë formën dhe mënyrën e komunikimit të zyrtarëve të AKK, dhe përfaqësuesve të IAAP-ve, gjatë gjithë procedurës të cilën e zhvillon AKK nga faza para aplikimit, e deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

## Neni 2

### Përkufizimet

**AKREDITIMI** - nënkupton procesin nëpërmjet të cilit autoriteti përgjegjës i njeh dhe autorizon institucionet që ofrojnë, vlerësojnë dhe certifikojnë kualifikime të validuara në KKK. Institucionet e akredituara duhet të jenë objekt i monitorimit dhe auditimit nga autoritetet gjegjëse.

**VALIDIMI** - përfshinë procesin në të cilin kualifikimet i nënshtrohen vlerësimit nëse i plotësojnë kriteret për t'u përfshirë në KKK.

**APROVIMI** - nënkupton procesin nëpërmjet të cilit autoriteti përkatës i njeh kualifikimet. Aprovimi jepet për një periudhë të caktuar dhe në fund të kësaj periudhe, kualifikimi duhet t'i nënshtrohet riaprovimit.

**NJOHJA E MËSIMIT PARAPRAK** - nënkupton procesin e vlerësimit të njohurive, shkathtësive ose kompetencave më të gjëra, të cilat një individ i ka arritur më herët nëpërmjet mësimit formal, joformal ose informal.

**AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE (AKK)** - është organ i pavarur i krijuar me ligj, i cili ka hartuar Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe ka për qëllim rregullimin e Sistemit të Kualifikimeve Kombëtare (Ligji për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, nëntor 2008).

**KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE (KKK)** - është mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve të dhëna brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve, sipas një grupi të kriterëve që i përcaktojnë nivelet dhe llojet e rezultateve të mësimit.

**SISTEMI I KUALIFIKIMEVE** - nënkupton sistemin e plotë brenda të cilit jepen dhe certifikohen kualifikimet, që përfshijnë kornizën kombëtare të kualifikimit dhe dispozitat ligjore për rregullimin e dhënies së kualifikimeve.

**KËSHILLI DREJTUES I AKK (KD i AKK)** - përbën 13 anëtarë dhe që përfaqësojnë ministrinë relevante, universitetet publike, partnerët social, organizatat joqeveritare dhe ofrues privat, të cilët kanë përgjegjësi për politikën zhvillimore dhe vendimmarrjen lidhur me KKK-në.

**EKSPERTËT E AKK**- anëtarët e brendshëm të AKK të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe zbatimin e politikave lidhur me KKK, si dhe zhvillimin, koordinimin dhe mbarëvajtjen e proceseve të verifikimit të standardeve të profesionit, validimit, akreditimit, akreditimit të NjMP dhe monitorimit të IAAP.

**EKIPET E EKSPERTEVE** - anëtarët e jashtëm të panelit vlerësues të angazhuar nga AKK sipas listës së miratuar nga KD i AKK për t'u përfshirë në procesin e verifikimit të standardeve të profesionit, validimit, akreditimit dhe akreditimit të NjMP.

**IAAP** - do të thotë çdo institucion që ofron, vlerëson dhe certifikon kualifikime të arsimit dhe aftësitë profesionale dhe për të rritur.

**DOSJA E APLIKIMIT** - të gjitha dokumentet e kërkuara sipas kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga AKK për procesin e validimit, akreditimit apo akreditimit të NjMP.

### **Neni 3**

#### **Informimi i palëve të interesit nga AKK**

1. Me qëllim të informimit paraprak të IAAP-ve, të cilat shprehin interesim për të aplikuar, AKK bënë publike të gjitha standardet dhe kriteret të cilat duhet të përmbushen nga IAAP-të për procesin të cilin e zhvillon AKK.
2. Për çdo ndryshim të këtyre standardeve apo kriterëve të aplikimit, AKK njofton të gjitha IAAP-të, të cilat janë funksionale, dhe të njëjtat i bënë publike për të gjitha palët e interesuara.

### **Neni 4**

#### **Faza para aplikimit**

1. Përfaqësuesit e IAAP të cilët dëshirojnë të aplikojnë për akreditim, validim, apo njohje të mësimi paraprak, mund të kërkojnë një takim informues me ekspertët e AKK-së për të marrë informata dhe udhëzime për përgatitjen e dokumentacionit për aplikim.
2. Kërkesa për takim duhet të drejtohet në adresën zyrtare të AKK përmes email-it. Forma e kërkesës për takim është hartuar nga AKK. Ky format është publik dhe mund të gjendet në uebfaqen dhe në zyrat e AKK.
3. Në rast se në takim nuk merr pjesë themeluesi i IAAP-së, përfaqësuesit e tyre duhet të kenë autorizimin e themeluesit me të cilin konfirmohet se personat pjesëmarrës janë të autorizuar ta përfaqësojnë IAAP-në në AKK. Ky autorizim duhet të jetë i vërtetuar tek noteri.
4. Takimi mund të organizohet me qëllim të informimit të përfaqësuesve të IAAP-së me procedurat, kriteret dhe standardet të cilat do të aplikohen nga këta të fundit në përgatitjen e dosjes së aplikimit.



## Neni 5

### Formati i aplikimit

Të gjitha IAAP-të të cilat shprehin interesim për të aplikuar në AKK, për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, apo për akreditim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP), duhet që dosjen e tyre të aplikimit ta hartojnë në përputhje me dispozitat ligjore, Udhëzimet Administrative, standardet dhe kriteret e vendosura nga AKK.

## Neni 6

### Afati i trajtimit të aplikacionit të IAAP nga AKK

Dosja e aplikimit e dorëzuar nga IAAP për akreditim institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, apo akreditim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP), do të trajtohet nga AKK brenda periudhës një vjeçare nga data e aplikimit, apo me së largu gjashtë muaj nga miratimi i aplikacionit nga ana e Këshillit Drejtues të AKK-së.

## Neni 7

### Trajtimi i aplikacionit nga AKK

1. Pas dorëzimit të dosjes së aplikimit nga IAAP për akreditim të institucionit, validim të programit, apo NjMP, ekspertët e AKK-së marrin në shqyrtim aplikacionin e IAAP-së.
2. Ekspertët e AKK-së do të vlerësojnë nëse aplikacioni i dorëzuar është përgatitur sipas kriterëve dhe standardeve të përcaktuara nga AKK. Ekspertët e AKK-së hartojnë një raport me të cilin konfirmojnë gjendjen e aplikacionit.
3. Në rastë se ekspertët e AKK-së konstatojnë që aplikacioni nuk është i kompletuar sipas dispozitave ligjore në fuqi, atëherë njoftohet IAAP që brenda afatit prej një (1) jave të plotësohet aplikacioni. Pas këtij afati, aplikacioni i IAAP bashkë me raportin vlerësues të ekspertëve të AKK-së, do të procedohet me tutje për vendimmarrje tek Këshilli Drejtues i AKK-së.
4. Raporti i ekspertëve të AKK-së duhet të përmbajë gjendjen e aplikacionit, duke ju referuar dispozitave ligjore në fuqi, kriterëve dhe standardeve të aprovuara nga AKK.

cfp.

5. Në fund të këtij raporti, ekspertët e AKK-së duhet të konfirmojnë plotësimin apo mos plotësimin e kushteve të aplikacionit për tu aprovuar apo jo nga Këshilli Drejtues i AKK-së.
6. Në rastet kur aplikacioni i plotëson kushtet e parapara sipas dispozitave ligjore në fuqi, standardeve dhe kriterëve të AKK-së, ekspertët përmes Drejtorit i rekomandojnë Këshilli Drejtues që ta aprovojë aplikacionin.
7. Në rastë se ekspertët e AKK-së vlerësojnë se aplikacioni nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kriteret dhe standardet e përcaktuara nga AKK, atëherë rekomandohet që aplikacioni të refuzohet.
8. Bazuar në rekomandimin e ekspertëve të AKK-së të cilët kanë trajtuar aplikacionin e IAAP-së, Këshilli Drejtues i AKK-së merr vendim për aprovim apo refuzim të aplikacionit.
9. Në rastë se Këshilli Drejtues i AKK-së merr vendim për aprovim të aplikacionit, atëherë ky i fundit autorizon Drejtorin e AKK-së për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të procesit, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.
10. Në rastë se Këshilli Drejtues i AKK-së merr vendim për refuzim të aplikacionit të IAAP-së, me vendimin e tillë njoftohen të gjitha palët e interesit, dhe të njëjtit i lëshohet vendimi i Këshilli Drejtues brenda afatit të paraparë me dispozita ligjore në fuqi.
11. IAAP mund të tërhiqet nga procesi i vlerësimit në AKK më së voni një javë (7 ditë) para marrjes së vendimit nga ana e Këshillit Drejtues.
12. Nëse një IAAP vendos të tërhiqet nga procesi i vlerësimit në AKK, një gjë të tillë duhet ta bëjë përmes një shkrese/njoftim zyrtar me të cilën e informon AKK / Këshillin Drejtues si organ vendimmarrës.
13. Mjetet e paguara për procesin vlerësues nga IAAP, nuk kthehen.

## Neni 8

### Procedura për ri-akreditim dhe ri-validim

1. IAAP duhet të aplikojnë për ri-akreditim, ri-validim, dhe për ri-akreditimin e institucioneve që zbatojnë NjMP, të paktën një vit para datës së skadimit të akreditimit të fundit.



2. Procedura e riakreditimit dhe rivalidimit, është e njëjtë me procedurat paraprake, përveç nëse parashihet ndryshe me dispozita ligjore ne fuqi.
3. Pas skadimit të akreditimit dhe validimit apo akreditimit të institucioneve që zbatojnë NjMP të një Institucioni të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional, AKK nuk do t'i vërteton certifikatat apo diplomat e lëshuara nga ky institucion.
4. Nëse një IAAP nuk aplikon me kohë për vazhdimin e akreditimit, atëherë ky aplikim do të trajtohet si akreditim fillestar.

## Neni 9

### Përbushja e obligimeve financiare

1. Të gjitha IAAP-të janë të obliguara t'i përbushin obligimet financiare ndaj AKK-së për procesin e vlerësimit, duke u bazuar në tarifatat e përcaktuara nga AKK.
2. Këto detyrime financiare duhet të përbushen më së largu tridhjetë (30) ditë pas aprovimit të aplikacionit të IAAP-së nga ana e Këshillit Drejtues të AKK-së.
3. Njoftimi për aprovim të aplikacionit dhe shuma e pagesës për proces do të bëhet nga AKK. Kalkulimi i kostos së procesit do të llogaritet sipas tarifave të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ.
4. AKK rezervon të drejtën që varësisht nga procesi, natyra e kualifikimit dhe angazhimi i ekspertëve vendor, rajonal apo ndërkombëtar, të bëjë ri-kalkulimin e kostos së procesit.
5. Në rastet kur një IAAP nuk përbush obligimin financiar brenda afatit të caktuar në pikën një të këtij neni, konsiderohet se ky institucion ka hequr dorë nga kërkesa e tij në AKK për trajtim të mëtutjeshëm.
6. Në këtë rast, për mos përbushjen e obligimeve financiare nga IAAP, Drejtori i AKK-së njofton Këshillin Drejtues dhe i njëjti merr vendim për refuzim të aplikacionit.

## Neni 10

### Procedura pas aprovimit të aplikacionit nga Këshilli Drejtues i AKK-së

1. Pas aprovimit të aplikacionit nga Këshilli Drejtues dhe përbushjes së obligimeve financiare nga IAAP sipas pikës një të nenit 8 të kësaj Rregulloreje, Drejtori i AKK-së

autorizohet nga Këshilli Drejtues i AKK-së për vazhdimin e procedurave të mëtutjeshme të vlerësimit.

2. Bazuar në aprovimin e Këshillit Drejtues të aplikacionit dhe varësisht nga natyra profesionale e aplikacionit, AKK angazhon ekspertë të jashtëm për vlerësimin e IAAP-së, varësisht nga fusha përkatëse.
3. Pas vlerësimit dhe shqyrtimit të aplikacionit, vizitës dhe takimeve në IAAP, ekipi i ekspertëve harton raportet përkatëse sipas legjislacioneve ne fuqi, kritereve dhe standardeve të AKK-së.

## Neni 11

### Roli i ekspertëve të AKK-së pas aprovimit të aplikacionit nga Këshilli Drejtues

1. Gjatë gjithë kohës sa zgjatë trajtimi i aplikacionit të IAAP-së, drejtori i AKK-së, Këshilli Drejtues, apo ekspertët e jashtëm mund të kërkojnë ndihmën profesionale të ekspertëve të AKK-së.
2. Ekspertët e AKK-së, bazuar në ekspertizën e tyre dhe varësisht nga natyra e aplikacionit të IAAP-së, propozojnë tek drejtori i AKK-së përbërjen e ekipit vlerësues, nga lista e ekspertëve të aprovuar nga Këshilli Drejtues, të cilët duhet të angazhohen sipas fushave të dosjes së aplikimit të IAAP-së.
3. Ne rastet kur ne listën e ekspertëve të aprovuar nga Këshilli Drejtues, nuk gjenden ekspertë të cilët duhet të angazhohen bazuar në natyrën e dosjes së aplikimit, atëherë drejtori në bashkëpunim me ekspertët e brendshëm të AKK-së, duhet të angazhohet për përzgjedhjen e ekspertëve të tjerë, vendor, rajonal apo ndërkombëtar.
4. Pas shqyrtimit të propozimeve të ekspertëve të AKK-së, Drejtori i AKK-së vendos rreth përbërjes së ekipit vlerësues.
5. Pas formimit të ekipit vlerësues, në koordinim me IAAP, organizohet data dhe agjenda e vizitës, me qëllim të vlerësimit për përmbushjen e kritereve dhe standardeve nga institucioni aplikues.
6. Pas përfundimit të vizitës nga ekipi vlerësues, këta të fundit hartojnë draft raportin, të cilin e përcjellin për komente përmes AKK-së tek IAAP. Brenda afatit të përcaktuar, IAAP mund të jep komente në të gjeturat e ekipit vlerësues. Pas komenteve të pranuar nga IAAP, ekipi vlerësues harton raportet finale. Këto raporte i dërgohen AKK-së për procedim të mëtutjeshëm në vendimmarrje.

7. Pas pranimit të raporteve nga ekipet e eksperteve të jashtëm të përfshirë në proces, ekspertët e brendshëm të AKK-së do të japin një vlerësim të përgjithshëm për raportin e ekspertëve.
8. Në rastë se raportet përmbajnë të gjitha kriteret dhe standardet e parapara me dispozita ligjore në fuqi, atëherë këto raporte përcillen më tutje për vendimarrje në Këshillin Drejtues të AKK-së.
9. Në rastëse raportet e ekspertëve të jashtëm kanë mangësi dhe nuk kanë trajtuar kriteret dhe standardet që ka paraparë AKK, atëherë ekspertët e AKK-së i rekomandojnë ekipit vlerësues që të plotësojnë raportet në harmoni me standardet dhe kriteret e AKK-së, duke ju referuar mangësive të gjetura në raportet e ekspertëve.
10. Ekipi i ekspertëve vlerësues është i detyruar të reflektojë sipas rekomandimeve të ekspertëve të AKK-së në afat jo më larg seshtatë (7) ditë nga momenti i pranimit të rekomandimeve nga ekspertët e AKK-së.
11. Në rastë se ekipi i ekspertëve nuk ka reflektuar në raportet finale sipas rekomandimeve të ekspertëve të AKK-së, atëherë këta të fundit mund t'i rekomandojnë Këshillit Drejtues që këto raporte të refuzohen, me arsyetimin se këto raporte nuk janë hartuar në përputhje me dispozitat ligjore, standardet dhe kriteret e aprovuara nga AKK.

#### Neni 12

#### Kontributi i Drejtorit dhe ekspertëve të AKK-së në vendimarrje të Këshillit Drejtues

1. Pas pranimit të raporteve vlerësuese nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, anëtarët e Këshillit Drejtues, mund të kërkojnë sqarime, apo informata shtesë rreth ndonjë çështje të caktuar që ka të bëjë me çështjet të cilat janë objekt i vendimarrjes në Këshillin Drejtues.
2. Drejtori dhe ekspertët e AKK-së do të japin të gjitha informacionet e nevojshme të vlefshme për vendimarrje tek Këshilli Drejtues, nëse kjo konsiderohet e nevojshme nga kjo e fundit.
3. Këshilli Drejtues mund të kërkojë edhe vlerësim profesional nga ekspertët e AKK-së të cilët kanë marrë pjesë bashkë me ekipin vlerësues në një IAAP.

anf.b.

4. Nëse Këshilli Drejtues konstaton se raporti i ekipit vlerësues është i mangët dhe nuk trajton të gjitha standardet dhe kriteret e parapara nga AKK, atëherë ky raport mund të refuzohet dhe të kërkohet rivlerësim me një tjetër panel vlerësues.

### Neni 13

#### Shmangia e konfliktit të interesit

Të gjithë zyrtaret e AKK-së, dhe anëtarët e ekipit vlerësues duhet të deklarojnë në çdo kohë paraprakisht situatën e konfliktit të interesit, dhe për këtë fakt ta njoftojnë drejtorin e AKK-së. Situata e konfliktit të interesit duhet të trajtohet konform Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

### Neni 14

#### Dispozitat përfundimtare

1. Në rastet kur kjo Rregullore bie ndesh me dispozitat e tjera ligjore, apo Udhëzimet Administrative të cilat e rregullojnë fushën ku vepron AKK, atëherë përparësi do t'u jepet dispozitave ligjore, dhe udhëzimeve administrative të cilat e rregullojnë këtë fushë.
2. Kjo Rregullore mund të ndryshohet nga Këshilli Drejtues, me propozimin e Drejtorit të AKK-së, me qëllim të përshtatjes së dispozitave ligjore në fuqi, apo avancimin e standardeve, dhe kriterëve të cilat aplikohen nga AKK.
3. Pas miratimit të kësaj Rregulloreje, AKK do t'i informojë të gjitha IAAP-të dhe të njëjtën do ta bëjë publike në ueb faqen e AKK-së, me qëllim të informimit të të gjitha palëve të interesit.

### Neni 15

#### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetari i KD së AKK



Prishtinë, 01.12.2020